

RILINDASI

Viti II - Nr:34

E diel, 26 gusht 2012

Kryeredaktore: Admirina PEÇI

Na ndiqni edhe online

www.shqiptarja.com

PRANVERA E DEMOKRACISE

Ditari dhe fotot ekskluzive të grevës së urisë të 1991

Nga Pjeter Logoreci

Me dëshirën e mirë të përkujtoj këtë ngjarje jo të zakonste, mbasi po afrohet dita jubilarë e saj SHTATOR 1991, do mundohem të rreshtoj disa kujtime në respekt të kolegëve që vëndosen të vetëflijohen, për të ba present respektimin e të drejtave njerzore dhe për të diskutitue ideologjinë vrasëse të komunizmit. Ja kushtoj këtë shkrim kolegut të paharruem të ndërjit Pano Taci, i cili ishte pjesmarrës aktiv i kësaj greve, me të cilin pata shumë biseda e shkëmbime mendimesh që më vlejten ma vonë.

Në Shkodër, verën e vjetit 1991, në ndërtesën e familjes Liridashëse e antikomuniste Martini, në katin përdhese gjndeshin zyrrat e porsa hapuna të shoqatës së përndjekunve politik – dega



Në foto: Grevistë e urisë më 1991 dhe një faksimile e lista e te burgosurve politik qe u futen ne greve urie

Shkodër. Menjherë të binte në sy vorfnia e ambientit, që përveç do stolave a karrigave të vjetra, në zyrën e „kryetarit“ gjindej një tryezë e vjetër mbi të cilën qe vendosë një makinë shkrimit dhe vula e re e shoqatës të sapokrijume antikomuniste.

Njerëz me fytra të vrame e të veshun keq hynin e delnin me ndonji pako ndër duer plot me rroba të vjetra ndihmash, apo me ndonji dëshmi panaliteti a dokumenta që vërtetonin vitet e vështrira të burgut.

Vezullime shprese e radhë buzëqeshje mund të shihje ndër fytyrat e rreshkuna prej diellit e vuetjveve të burrave që përshkoheshin në derën e vjetër prej drunit sipër të cilës varej një tabelë e shkrueme me ngut nga një dorë amatore: Shoqata e të përndjekunve politik. Dega Shkodër.

Mbrendë, zotnijtë Vitor Martini e...

vijon në faqen 14-15

Ku janë gravurat që Muzeu i Luvrit i dhuroi Shqiperisë më 1923

Zbulohet letra e 8 marsit 1923 ku ministri Rexhep Mitrovica falenderon drejtorin e Muzeut të Luvrit për dhuratën që ky muze i ka bërë Muzeut Kombëtar në Tiranë, 36 gravura që janë sjellë në Shqipëri përmes Justin Godart...

Frederik Stamati

SEUMIT SHQIPËTAR

Nr 20.

Zoti Drejtor,

Ndonëse i përqën druarr tërësisht në kërkimin e historive për flamujt më të famshëm të Shqipërisë, gjeta pa priturr në Arkivin e Shtetit një letër në frengjisht të ministrit të arsimit të vitit 1923, zotit Mitrovica, që i dërgohej drejtorit të Muzeut të Luvrit në Paris. Letra ishte shkruar me shkrim dore, një shkrim i bukur dhe i qartë, që mund të kuptohej lehtësisht. Sapo pashë në të emrin e Justin Godartit m'u ngrit mendja. E lexova pa e zgjatur nga kureshtja më e madhe. Ja se çfarë shkruan:

Tiranë, më 8 mars 1923

DIREKTORIA E MU-

Popullsia shqipëtare do të admirojë me interes të madh këto imazhe të bukura, duke përfutuar moralisht nga të gjitha këto etapa të shquara të historisë së kombit trim francez.

Më lejoni Zotëri t'ju falenderoj në emër të Qeverisë shqiptare për dhuratën e bërë me qëllimet...

faqe 16



Shën Pali Shqiptar dhe Shën Kostandini Shqiptar së bashku por ndryshe

Shën Pali Shqiptar dhe Shën Kostandini Shqiptar janë pjesë e mërgimit të fundit dhe më madh të refugjatëve shqiptarë, ai që shkon nga viti 1532-34, pas pushtimit strategjik të turqve të Peloponezitet

faqe 20

Të dhëna të reja mbi krishtërimin e hershëm në Berat

Një studim i hollësishëm dhe sistematik gjatë këtyre 7 viteve të fundit mbi gjurmë e gjurmë të skulpturës arkitektonike që ka ekzistuar në ambientet e kishave dhe kalanë e Beratit...

Nga Dritan Çoku

Në fushën e studimit të ndërtimeve arkitektonike të periudhës së vonë antike (284-565) dhe të hershme mesjetare (565-850) në qytetin e Beratit, parajqitet një interes i veçantë për njohjen më të plotë të saj, pasi siç e dimë mungojnë të dhënat burimore. Në Berat janë gjetur një numër i konsiderueshëm i skulpturës arkitektonike, të cilat për nga numri dhe shumëllojshmëria e tyre dëshmojnë për një numër jo të vogël monumentesh, si dhe rëndësinë e qytetit në Antikitetin e Vonë. Nuk është e vërtetë sipas përmendjes të së njëjtës fraze dy herë në liter-

aturë, që "Asgjë nuk gjendet në qytetin e Beratit që të dëshmojë arkitekturën paleokristiane, veçse tri kapitela. I pari është si tryezë altari në kishën e shën Kollit pranë Vllahernës (fig.1); i dyti është një kolonë e vogël me kapitel të vendosur përmbys në dritaren e absidës së kishës së shën Todrit në kala (fig.2). (A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, "Berati historia dhe arkitektura", Tiranë, 1988, f.5, dhe revista periodike "Art dhe Trashëgimi", Prof. Dr. Aleksandër Meksi "Ndërtimet e kultit të krishterë në..."

faqe 17

KUJTIMET | FOTOT

PRANVERA E DEMOKRACISE

Ditari dhe fotot ekskluzive të grevës së urisë së '91

Nga Pjeter Logoreci

vijon nga faqja 13

...Ndrekë Pjetri mundoheshin të shërbenin odo njërit me mirsjellje e gadishmëri, mbasi merrnin veshit shkakun e ardhjes së tyne. Nuk më kujtohet saktësisht dita, por ishte mbledhja e kryesisë së degës. Dhoma ishte plot me anetarët e kryesisë, të ftuem, njerëz të thjeshtë, simpatizantë e aktivista. Do të diskutohej për hallet e shumta, por pika kryesore e rendit të ditës ishte thirrja e dergume të gjitha degëve të rretheve nga komiteti drejtues i shoqates kombëtare në Tiranë e firmosur nga Mandela shqiptar Osman Kazazi, për pjesëmarrjen në një grevë kombëtare në Tiranë.

Edhe pse themelet e komunizmit tashma ishin lëkundun e plasaritun, klasa politike e kohës nuk ishte gati të njihte problemet e të shëronte plagët e viktimave të pafajshme të sistemit të tyne gjaksor. Pra duhej me çdo kusht që kjo shtresë përseri të vetësakrifikohet në emër të lirisë e të demokracisë, për të arritë me realizue kërkesat e tyne minimale jetësore.

Bashkarisht u vendos pjesmarrja në grevë. Edhe pse pat dëshira të shumta për pjesmarrje nga gra e burra, u vendos të shkohej me një grup vullnetar prej 17 vetësh që ishin në gjendje të përballonin vështirësitë. Greva do të zhvillohej në ambientet e sportklub Tiranës në Rrugën e Kavajës në qendër të kryeqytetit.

Grupi i Shkodrës siç shihet edhe në foto ishin: (rreshti i parë në kambë) Agostin Coku, Agron Dakaj, Vitor Martini, Bardhyl Lohja, Gjetok Vukcaj, Dedë Matusha, Pjetër Logoreci, (rreshti i dytë) Ilir Malaj, Skënder Ymeri, Tomë Beqari, Nikolin Keka, Paulin Ndoja, Martin Matusha, (ulë në tokë) Andre Barbullushi, Ilir Isufi, Gjergj Qamuku, Shtjefen Lacuku.

Në paraditen e 20 Shtatorit të vjetit 1991 i gjithë grupi udhëtoj drejtë Tiranës dhe ju bashkue pjesë tjetër të njerzve të ardhun nga të gjithë rrethet e vendit. Emocionet ishin të papërshkrueshme në takimet në mes të bashkëvejetesve. Kujtime të vështira e të paharrueshme për ditët e lanuna pas, por që lanë plagë të paharrueshme në fizikun e psikikën e tyne. Shtërngime duersh, perqafime, kujtime nga ma të ndryshmet, atmosferë e dhimbëshme por edhe kënaqësi miqësore. Mandej ndarja nga familjarët dhe mbyllja në sallë.


Të paharrueshme do të më mbesin çastet e betimit solemn për ta que grevën deri në fund me çdo lloj çmimi, edhe me jetë. U zgjodh me shpejtësi një komitet drejtues i grevës, që do merrej me përkujdesjen shëndetsore të pjesëmarrësve që do kishin nevojë edhe për kontaktet me shtypin.

Situata politike në vend ishte

Ja kushtoj këtë shkrim kolegut të paharruem të ndërjit Pano Taci, i cili ishte pjesmarrës aktiv i kësaj greve, me të cilin pata shumë biseda e shkëmbime mendimesh që më vlejten ma vonë.



Në foto: (Majtas) Dita e parë e greves së urisë, 21.9 (Poshtë) Një grup i grevisteve të urisë me 25.9



Në foto: **Faksimile e dokumentit ku grevistët e urisë parashtruan 5 kërkesat e tyre**

shumë e veshtirë dhe delikate. Qeveria e stabilitetit e drejtuar nga Ylli Bufi nuk arrinte të kontrollonte situatën ku mbizotënonin levizjet për demokratizimin e vendit. Greva e mitingjet e njmbasnjishme që shprehnin pakënaqsinë popullore shtoheshin çdo ditë. Presidenti komunist Ramiz Alia dhe kasta e vjetër që e rrethonte ishin të padishrueshëm për njerzit. Të

U zgjodh me shpejtësi një komitet drejtues i grevës, që do merrej me përkujdesjen shëndetsore të pjesëmarrësve

g gjitha kto sollën një zemërim popullor që lexohej në sytë e çdo njeriu e që u shpreh me mirënjohje e përkrahje edhe për ne grevistët e urisë të ngujuem për të drejtat legjitime të moheume.

90 persona të ardhun nga të gjitha anët e vendit, që ishin shtresa më e vuetjun e kombit, ishin gadi të vetëflijoheshin për të kërkue realizimin e

të drejtave të tyre themelore të mohueme nga diktatura. Ish të burgosun e të internum, dikush që përfaqëson te vëllain e pushkatuëm, një tjetër babën e vdekur në burg e që nuk i di hej varri, një tjetër familjen..... Ishin rreth 2000 vjet burg në atë sallë sporti, që gjatë ditës, me ecëjaket e grevistave të kujtonte oborrin e burgut famëkeq të Spacit.

Këto njerëz ishin me moshë të ndryshme, me prejardhje të ndryshme familjare, por të burgosun nga i njëjti ligj famëkeq, ai i agitacionit e propagandës.

5 kërkesat tona ishin nga ma të thjeshtat dhe krejt njëzore, për një jetë normale e integracjon: 1. Pafajësia, 2. Çdëmtimi material në bazë të normave ndërkombëtare, 3. Strehimi, 4. Punësimi mbrendë e jashtë vëndit, 5. Shkollimi...

Peticioni me këto kërkesa ju dërgue Presidentit të Republikës, Parlamentit dhe Qeverisë. Të shumtë ishin shoqatat, sindikatat, partitë politike, gazetatat, që i përkrahën këto kërkesa dhe këte lëvizje. Me kalimin e ditëve lëvizja jonë kaloi kufijtë e atdheut dhe pat reagime edhe nga shtypi ndërkombëtar dhe përfaqësitë e huaja në vend. Çdo ditë shtohesh numri i gazetarve perëndimorë që kishin dëshirë të pasqyronin vuetjtet e mjerimn nga rregjimi komunist dhe dëshirën e madhe për liri e demokraci të popullit shqyptar.

Më kujtohet një ndodhi e pa zakonitë me një grup gazetarësh e kameramanësh gjermanë, të cilët në ditën e 5-të të grevës intervistuen shumë ish të burgosun e ndigjuen historina nga më absurdet për nga mohimi i të drejtave njerzore. Gjatë bisedës me njërin nga kolegët, i cili po tregonet për torturat çnjerzore në qelitë e burgut të Burrelit, njerit prej kameramanëve i ra kamera nga dora dhe i asfiksuem ra pertokë pa ndjenja.

Po kështu kam të gjallë në kujtesë vizitat e shumta të shoqatave nga rrethet e ndryshme të vëndit, politikanëve, studentëve, grupeve të ndryshme për të drejtat e njeriut e ish shokëve bashkëvujtes të burgut. Në mesin e ish të burgosurve, kishte edhe persona që rridhnin nga ish blloku, femijë të anëtarve të byrosë apo të anëtarve të komitetit qëndror të partisë së punës, ministrave komuniste, të cilët ranë vetë viktimeë në burgjet që baballarët e tyre sajuen për njerzit e thjeshtë. Rasti e sollë që të ndigjoj fjalë të mira për sjelljet e tyre në burg, por edhe nganjëherë pa shë të kishte allergji e reagim negativ.

Aty nga dita e 8-të erdhën të na vizitojnë një grup deputetësh dhe ministrash të qeverisë të stabilitetit, për të dhanë mesazhin që "po përpiqeshin" të analizojnë kërkesat tona, e ndodhi që një ministër, djalë nga familjet komuniste të ish bllokut, u flak dhunshëm nga grevistët jashtë mbi asfalt....

Vetëmohimi për ta çuar grevën deri në arritjen e plotësimit të kërkesave u ba motivi kryesor i qëndrësës të ish burgosurve edhe pse ishin të lodhur nga vuajtjet e burgut e nga mungesa e ushqimit gjatë grevës. Pat raste që grevistë dergoheshin në spital për trajtim, por që me këmbëngulje kërkonin të ktheheshin pranë shokëve.

Çdo mbasdreke qindra qytetarë të Tiranës mbildheshin në oborrin para sallës



ISH TE BURGOSURIT POLITIK PERSERI NE VETEFLLIIM

- | | | |
|----------------------|------------------------|-----------------------|
| 1) Viktor Martini | 31) Napolica Koleci | 61) Sllender Baria |
| 2) Haki Bulku | 32) Hasan Durishti | 62) Xhemil Demi |
| 3) Agron Dakaj | 33) Odhise Mërtiri | 63) Nivolin Koka |
| 4) Vladimir Xhelo | 34) Hakuran Skuka | 64) Ahmet Hugu |
| 5) Vladimir Xhelo | 35) Riza Tërti | 65) Tom Bogari |
| 6) Gjeçit Qonuku | 36) Ilir Isufi | 66) Sllender Ymeri |
| 7) Bardhyl Lohis | 37) Vladimir Kosturi | 67) Shlljetin Lacuku |
| 8) Demir Abazi | 38) Leonard Lemja | 68) Medi Dako |
| 9) Paulin Ndoja | 39) Maktari Xhunkaku | 69) Ramadan Demiri |
| 10) Kadri Rama | 40) Ahmet Tufa | 70) Fllçler Logoreci |
| 11) Maço Karaj | 41) Pano Taçi | 71) Shllqim Kurti |
| 12) Ferdinand Metaj | 42) Përpartin Allmadi | 72) Veli Haxhiraj |
| 13) Gëzim Bebah | 43) Susan Allmadi | 73) Ali Gjoni |
| 14) Agron Talo | 44) Ferit Sllenderi | 74) Arben Sengia |
| 15) Hyzen Tabaku | 45) Adriatik Allmadi | 75) Halim Qejvani |
| 16) Ilirian Cerepi | 46) Agron Allmadi | 76) Shik Sllernadi |
| 17) Hyzen Doka | 47) Hyzen Xhëta | 77) Ali Kulla |
| 18) Masha Dëba | 48) Dhimitër Dhaokali | 78) Yll Bllazi |
| 19) Tomerr Gora | 49) Alfred Kamami | 79) Durrer Koleci |
| 20) Haxhi Sulis | 50) Arben Jabo | 80) Gjeçto Vukaj |
| 21) Shllqim Basha | 51) Arben Driza | 81) Qazim Visha |
| 22) Ilir Malaj | 52) Sami Lushaku | 82) Besim Valteri |
| 23) Agron Kallaja | 53) Haxhi Bacinoveli | 83) Mesan Abazi |
| 24) Dël Matasha | 54) Ruzhah Ceta | 84) Fatos Kërçuku |
| 25) Agustin Çoku | 55) Ruzhat Qevaja | 85) Adem Xhafari |
| 26) Martin Matashu | 56) Isken Çenko | 86) Mërtin Vllahi |
| 27) Ramadan Lipe | 57) Paskal Simaku | 87) Veriazimin Ramxho |
| 28) Petrit Horiet | 58) Sllëjman Doda | 88) Fadil Daja |
| 29) Enver Mustafaraj | 59) Qazim Toro | 89) Hyzen Haxhaj |
| 30) Bedri Bllahini | 60) Andrea Barbullushi | 90) Haxhi Malaj |

Në foto: (Lart) Greviste e urise (Majtas) Lista e te burgosurve politik qe u futen ne greve urie ne shtator te 1991 (Poshtë) grupi i grevisteve të urise nga Shkodra

sportive në shenjë solidaritetit. Shpesh ndodhte që të hidheshin parulla kundër qeverisë, kur nga dritaret e palestres Vitor Martini apo Vladimir Xhelo njoftonin për gjendjen ditore të grevistëve.

Ditët kalojshin plot me rreziqe të dukshme me shëndetin e pjesmarrësve, por për shtetit vetëm heshje....

Dinosauri komunist Ramiz Alia, në rrokullisje e sipër, synonte përsëri jetë njerzore e gjak të pafajshëm. Ndënjë deputet i opozitës, jo me prejardhje komuniste e që i njihje rrethanat e jetës së burgut si Pjetër Arbnori, përpiqej të imponohej te shteti, por pa rezultat.

Osman Kazazi, shtëpia e të cilit ishte ba bazë qëndrimi e informacionit për të ish të burgosunit e familjarët e tyre, ishte i angazhuem me kontaktet e bisedimet për realizimin e kërkesave me politikën. Ishte dita e 11-të. Gjendja shëndetsore dhe higjenike në sallën e grevës ishte e përkeqsue jashtë çdo kufini njerzor, kur një lajm i mirë ngrohu shpirtin e trazuem të grevistave. Qeveria e stabilitetit kishte vendosun të marrë parasysh kërkesat e të përndjekurve. Por rezultati konkret i lëvizjes sonë ishte rrezimi më pas i qeverisë neokomuniste të stabilitetit dhe dalja e dekretit për zgjedhje të reja në shkurt 1992 ku demokracia fitoj bindshëm.

Pas 10 ditë greve, parlamenti miratoi njëzëri një ligj gjysmak, për të cilin të përndjekunit kanë edhe sot shumë pakënaqësi dhe ndjehen të pa përfaqësue.

Shpresoj që greva KOMBETARE E ISH TE PERNDJEKURVE POLITIK, në vazhden e lëvizjes antikomuniste, do të zanë vend në mes të ngjarjeve të randësishme që janë të ekspozueme në muzeun kombëtar në seksionin e luftës kundër komunizmit.

